



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal
Datë: 11.02.2026

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesja e Kuvendit me datë: 11.02.2026 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -II-të të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë: **19.02.2026**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.
Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Të ndryshme.

Arbnore BEQIRAJ FERA

Kryesuese e Kuvendit të Kamenicës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më: 22.01.2026

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç anëtarëve të pranishëm ishin, shërbimi profesional i kuvendit, përfaqësues nga OSBE-ja. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e Komitetit për Politikë dhe Financa, Arbnore Beqiraj Fera e cila për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Raportit i punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025,
2. Raporti i Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025,
3. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2024
4. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën Tetor-Dhjetor 2025 (TM4).
5. Të ndryshme.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, përshëndetje për të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe gjithë juve të pranishëm, mirë se po takohemi në mbledhjen e I-rë të këtij komiteti, materialin dhe rendin e ditës e keni mare me kohë, konstatoj se kemi kuorum të mjaftueshëm për të filluar këtë mbledhje.

A keni propozime shtesë, nëse jo, e hedhim në votim Rendin e Ditës

Kush është për miratimin e Rendit të Ditës

Për, u deklaruan të gjithë

1. Shqyrtimi i Raportit i punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal - jemi në pikën e parë të rendit të ditës, Raporti i Punës së Kryetarit, ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet e punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e dytë. Propozoj që ta miratojmë Raportin e Punës së Kryetarit dhe i njëjti të shqyrtohet në mbledhjen e kuvendit, ku prezent do të jetë edhe Kryetari i cili do ta prezantoj këtë raport.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për, u deklaruan të gjithë.

2. Raporti i Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal - jemi në pikën e dytë të rendit të ditës, Raporti i Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025, në këtë raporte janë të përfshira të gjitha aktivitetet e kuvendit komunal për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2025.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për, u deklaruan të gjithë.

3. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale për vitin 2024

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi në pikën e tretë të rendit të ditës Performanca komunale për vitin 2024, përmbledhjet dhe rezultatet e performancës komunale, ky proces është zhvilluar në tri faza kryesore, andaj kisha kërkuar nga ju që ta miratojmë si pikë të rendit të ditës këtu në KPF e ta prezantojmë në mbledhjen e Kuvendit.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Lidiona Marovcen (Kordinatore e Performancës) për ta prezantuar këtë raport

Lidiona Marovca- Zëdhënëse e Komunës (Kordinatore e Performancës)

Përschëndetje për të gjithë.

Duke ditur se paraqitjet e mia para kuvendit apo komiteteve të tilla janë të rralla, shfrytëzoj rastin të ju uroj për mandatin e ri, duke ju uruar një mandat të mbarë dhe një vit të mbarë, sidomos duke uruar që në secilën ngritje dore që bëni në këtë kuvend të jetë në interes të qytetarit dhe gjithmonë pjesë e bazës të jetë vet ai.

Më lejoni që të bëjë një prezantim të shkurtër rreth pjesës së performancës për vitin 2024 për Komunën e Kamenicës.

Raportimi për vitin 2024 nga Komuna e Kamenicës, ka përfunduar tre ditë para kohës së paracaktuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për dallim nga komunat e tjera që kanë kërkuar kohë shtesë, kohë kjo e fituar nga ne për të përmirësuar dhe ndryshuar raportimin e bërë deri në atë kohë. Në kuadër të raportimit, Komuna e Kamenicës ka marrë gjithsej 32 pikë nga 98 pikë të mundshme, për 29 tregues gjithsej.

Kjo gjë nuk e kualifikon Komunën e Kamenicës për të qenë përfituese e grantit.

Komuna e Kamenicës, ka plotësuar vetëm tri nga 4 kushtet minimale për të qenë përfituese, që janë:

1. Komuna ka raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të paracaktuar në nenin 19.2 të ligjit për SMPK/GPK,
2. Komuna ka respektuar obligimin ligjor për të rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikqyrës,
3. Si dhe opinioni i auditimit është i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Kurse kushti i vetëm që Komuna e Kamenicë nuk ka arritur që ta plotësojë, është shpenzimi i 75% apo më shumë i buxhetit për investime kapitale, sepse Komuna e Kamenicës për vitin 2024 ka shpenzuar vetëm 66% e buxhetit për investime kapitale.

Kjo ndodhë për arsye të ndryshme, duke filluar nga procedurat në prokurim, vonesat në realizim të punëve e puna e zhvilluar nga operatori ekonomik.

Nëse dikush ka ndonjë pyetje, urdhëroni.

Ju falemnderit shumë!

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, faliminderit Lidiona

Kush është miratimin e kësaj pike ?

Për, u deklaruan të gjithë

4. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën Tetor-Dhjetor 2025 (TM4).

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën Tetor-Dhjetor 2025, në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit neni 45, 54.4 Kryetari i Komunës duhet të përgatit dhe dorëzoj Kuvendit Komunal Raportin tremujor të cilat mbulojnë vitin fiskal të tremujorit të sapo përfunduar, ky raport duhet ti dorëzohet kuvendit komunal. A keni diskutim?

Kush është kjo deklaratë të vazhdoj ?

Për, u deklaruan të gjithë.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Labinot Skovrqanin **Labinot Skovrqani- Anëtar**, kërkoj që të jetë herëve të tjera drejtori apo ushtruesit e detyrës kur të kenë pikë në rendin e ditës të jenë prezent.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Granit Berishën **Granit Berisha – Anëtar**, Përshëndetje për të gjithë faleminderit për kohën dhe mundësin, mendoj që duhet të zhvillohen diskutime dhe për këtë pikë është dashtë të jetë drejtori i kësaj drejtorie apo ndonjë përfaqësues dhe për herët e tjera duhet edhe ju si kryesuese ta keni parasysht që të jenë prezent.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, ne i kemi ftuar përmes thirrjes që të jenë prezent edhe atë, e për herëve të tjera do insistojmë që të jenë prezent drejtorët të cilët kanë pika në rend dite.

5. Të ndryshme

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal - a keni diskutime në pikën të ndryshme, a e dëshiron dikush fjalën për diskutim ?

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Magbule Kastratin **Magbule Kastrati-Anëtare**, faleminderit kryesuese përshëndetje për të gjithë, **Te Raporti i Punës së Kryetarit** për thirrjen e rregullt të kuvendit të i bashkëngjitet tek pika 33 trotuari në Kopernicë, rrjeti dhe ndriçimi publik nuk është e cekur metra, gjatësia, 1 km kërkoj që në mbledhjen e rregullt me ardhën kontrata e projektit.

Dekorimi i sheshit vlera 1200 Euro, me sa di unë në fundvit Sheshi nuk është dekoruar a bëhet fjalë për sezonin verë atë ndriçimin që e vendosni, nëse ka mundësi mu bashkëngjit materiali për këtë pikë?

Pastrimi i lumenjve dhe proçkave ka vlerë 150 mijë euro periudha 3 vjeçare, punët kanë filluar në Korrik 2025 ku janë kryer rreth 80 % e punëve, ndërsa realizimi i këtij projekti është në formë urgjente për pastrimin e lumenjve dhe proçkave, pagesa deri më tani është kryer 20.000 (njëzet mijë) euro, ndërsa 80 % e punëve të kryera ndërsa pagesa është bërë në vlerë vetëm 20.000 (njëzet mijë) Euro, më duket e pakuptimit, kërkojë të na bashkëngjitet për secilën materialin.

Sa i përket Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, kërkoj shpjegim nga Drejtoresha e kësaj drejtorie që të na bashkëngjit materialin e Administratës për Listën e Kërkesave të Certifikatave, të Kurorëzimeve, e të gjitha shërbimeve të Administratës, të hyrat e pagesave, tabelën. Ose të naj bashkëngjittë në material ose të vjen në Kuvend të na prezanton dhe informon, për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Granit Berishën

Granit Berisha – Anëtar, Kam një çështje e cilën dua me ngrit në mbledhjen e Kuvendit, ka të bëjë me Çerdhen në fshatin Koretin, ku të cilën pak para fushate apo në zgjedhjet Komunale është prerë edhe shiriti, sot përderisa po flasim ajo çerdhe nuk është funksionale. Kemi nevojë me na informuar se sa persona janë punësuar, cili është personeli dhe sa është numëri i tyre, ku janë ata të punësuar në angazhim, kur ka mu hap dhe pse nuk është në funksion a ka problematikë, çka nuk është në rregull, kërkojmë informacion për mbledhjen e rregullt, me theks të veçant sa janë të punësuar.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Magbule Kastratin

Magbule Kastrati- Anëtare, Kërkojmë që në mbledhjen e kuvendit të jetë prezent Drejtori i Arsimit, për të na dhënë sqarime.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Labinot Skovrqanin


Labinot Skovrqani- Anëtar, Nxehjet në shkolla, çka po ndodh në shumë shkolla nuk qëndrohet as mësimdhënësit as nxënësit pa jakne, ku është problemi na tregon **Drejtorja e Arsimit ?**

A janë bërë vlerësime për vërshimet që kanë ndodhur në Komunën e Kamenicës, cila është gjendja sa ka hapësirë komuna me mar për obligim , deri ku kanë arrit kërkesat e qytetareve për kompenzim të dëmeve? Kem nevojë me ditë sa ka kërkesa dhe me dit sa janë realizua a vlerësuar ?

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera, nëse jo. Shpallë dhe konstatoj të mbyllur takimin e sotëm.

Mbledhja përfundoj në ora: 10: 25

Procesmbajtëse



Violeta Krasniqi

Kryesuese e Kuvendit Komunal



Arbnore BEQIRAJ FERA